



Ahmet Qeriqi
Drejtore
"Radio Kosova e Lirë"
Nr. Biz: 80674988
Radio Kosova e Lirë
R052
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2013/18
Ref: 1306/719/LIC/II

VENDIM

lidhur me kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të transmetimit të Radio Kosova e Lirë, Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Kosova e Lirë është subjekt transmetues me mbulim lokal, i cili më datën 5 gusht 2010 është i pajisur me licencë afatgjate të KPM-së për të transmetuar radio programe në komunën e Prishtinës .
3. Më datën 14 mars 2013, drejtori i Radio Kosova e Lirë ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të transmetimit, me kalim në fshatin Berishë.
4. Më 27 maj 2013, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF), i Zyrës Ekzekutive të KPM-së ka bërë matjet teknike për të vlerësuar parametrat teknik dhe mundësitë për kalim të transmetimit të Radio Kosova e Lirë në pikën e propozuar për transmetim.

Arsyetimi

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, përcakton se, KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqytjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
6. Rezultatet e matjeve të bëra nga DMF tregojnë se ndryshimi i vendndodhjes së sistemit të transmetimit të Radio Radio Kosova e Lirë me transmetim nga pika transmetuese e propozuar paraqet ndryshim të mbulimit duke marrë parasyshë faktin

se distanca ajrore nga pika e licencuar për transmetim dhe ajo e propozuar është diku rreth 30 km, mirëpo, nuk interferon me asnjë frekuencë tjetër brenda brenda zonës së mbulimit.

7. Neni 6.1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së thekson se: *“përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Nenin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së”*.
8. Prandaj, në pajtim me nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së dhe 6.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, KPM konstaton se, kërkesa e palës për ndryshim të vendndodhjes së sistemit të transmetimit nga fshati Berishë i përmbush standardet e KPM-së për këto ndryshime të licencës së KPM-së dhe është në shërbim të audiencës së këtij subjekti transmetues.
9. Kërkesën dhe arsyetimin e Radio Kosova e Lirë për ndryshim të vendndodhjes së sistemit të transmetimit, KPM e pranon si të mjaftueshëm.

Vendim

10. Komisioni vendosë që Radios Kosova e Lirë ti lejohet ndryshimi i vendndodhjes së sistemit të transmetimit me kalim në fshatin Berishë.
11. Komisioni vendosë që ta udhëzojë përfaqësuesin e Radios Kosova e Lirë që të instalojë filtër dalës në transmetues.

Lëshimi i vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.


Shefki Ukaj
Kryetar

Komisioni i Pavarur për Media.



6 shkurt 2013
datë